

MELORE NE LIGJYKATA THEMELORE NE MITROVICË, (e vendosur ne  
 Pajtimin e objektit te Degës se kësaj Gjykate në Vushtrij), si kontestimore e  
 autorizuar dhe përbërë nga gjyqtari individual Faton Ademi, në çështjen juridike të  
 eja nga Padiçësia nga të cilën e përfaqëson sipas  
 autorizimit me shkrim Av. nga kundër të paditurit  
 nga të cilën e përfaqëson drejtori , baza  
 kontestit: Borgji pas mbajtjes së seancës kryesore të datës:  
 14.11.2013 me datën 18.11.2013 bie këtë:

## AKT GJYKIM

**OBLIGOHET**, i padituri që brenda afatit 15 ditor nga  
 plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi t'ia paguaj paditëses shumën  
 1500 euro në emër të borgjit me kamatë vjetore që paguhet në  
 lartësinë e mjeteve të deponuara ne bankat afariste pa destinim  
 të caktuar, nga data e parashtrimit të padisë dt. 24.01.2012, e  
 gjer në pagesën definitive, nën kërcënimin e ekzekutimit të  
 detyrueshëm.


**OBLIGOHET**, i padituri që në emër të shpenzimeve procedurale,  
 t'ia paguaj paditësit, shumën totale prej 300.80 euro dhe atë:  
 për përpilimin e padisë nga i autorizuari i paditëses, shumën prej  
 78 euro , takse gjyqesore per padi, shumën prej 20 euro, për  
 përfaqësim nga ana e avokatit në 2 seanca, 202.80 euro si dhe  
 gjykatës 20 euro taksë për përpilimin e aktgjykimit të gjitha këto  
 në afat 15 ditor nën kërcënimin e përmbartimit të detyrueshëm.

## Arsyetim

Paditësi me datë: 24.01.2012 ka parashtruar në gjykatë padi për  
 pagimin e borxhit që rrjedh nga kontrata për shfrytëzimin e diplomës  
 për licencim kundër të paditurit nga

Përfaqësuesi i paditëses në seancën e shqyrtimit kryesor të  
 dt.14.11.2013 dhe ne fjalën përfundimtare deklaroi se mbetet pranë  
 padisë dhe kërkespadisë, nga provat e propozuara dhe te administruara  
 në seancën e shqyrtimit kryesor nuk është kontestuese fakti se I  
 padituri për shfrytëzimin e licences nga muaji nëntor I vitit 2009 deri në  
 muajin mars 2010 nuk I ka përmbushur obligimet e veta, ashtu që  
 paditësi I ka mbetur borgji 1500 euro, gjykatës I propozoi që ta aprovoi  
 kërkespadin e paditësit. Shpenzimet e procedures I kerkoi. I autorizuari  
 i paditësit në seancë përgaditore I propozoi gjykatës që paditësin ta  
 dëgjoi në cilësi të palës.

Paditësi në fjalën përfundimtare deklaroi dhe e përkrahi në tërësi fjalën e të  
 autorizuarit tim dhe se nuk ka asnjë të shprehur.



Përfaqësuesi i të paditurit në seancën e shqyrtimit përgaditor të datës 22.10.2010 deklaroi se e kundërshtoi padinë dhe kërkespadinë e paditësit, shtoi se është e vërtetë se kemi lidhur kontratë për bashkëpunim me paditësin për periudhën 6 muajore me mundësi të rishikimit në emër të shërbimit të diplomës në shumën prej 300 euro në muaj, I cili çmim ka qenë I lartë por ne kemi qenë të detyruar ta pranojm për shkak të plotëcimit të kriterëve të operojm si kompani. Në korrik të vitit 2009 ne kemi kërkuar që paditësi të mbykqyrë një objekt, por I njëjti ka refuzar që ta mbykqyrë me konkretisht pjesen e kulmit si rezultat I të cilit ne kemi pësuar humbje në shumë prej 2700 euro. Me paditësin kemi nderprer bashkëpunimin pas 6 muajve, mirëpo ne dërsa kemi bërë çlajmrimin në Ministrinë e Tregëtisë dhe Industisë kanë kaluar disa muaj, andaj kjo është periudha për të cilën paditësi kërkon që ta kompenzojm edhe pse ai gjatë kësaj peridhe nuk ka qenë I angazhuar fare, ndërsa të njëjtit si shperblim ja kemi jep pagën edhe për muajin nëntor dhe dhjetor të vitit 2009 e cila pagë i është dhënë kesh pasi I njëjti nuk ka pranuar që ti bëhet transferi bankarë.

Për të vërtetuar gjendjen faktike gjykata administroi këto prova: kopja e licencës së ndertimit për " " nr. " " , vendimi i dt.23.02.2010 dhe i datës së protokolimit nga Ministria 22.03.2010, kontrata për bashkëpunim e lidhur në mes paditësit dhe të paditurit e dt.11.03.2009, historiati i pagesave dhe bilancit financiar për puntorin për vitin 2009 e dt.24.02.2010, kopja e shkresave dergaur të paditurit nga ana e të autorizuarit të paditësit e dt.17.12.2011.

Gjykata provat e administruara i vlerësoi në pajtim me nenin 7 dhe 8 të LPK-së dhe erdhi në këto konkludime:

Nuk është kontestues fakti se i padituri ka qenë shfrytëzues i diplomës për licencim, pasi kjo vërtetohet nga kontrata për bashkëpunim e lidhur në mes paditësit dhe të paditurit e dt.11.03.2009.

Faktin se i padituri deri me datën 22.03.2010 e ka përdorur licencën e paditësit, vërtetohet nga vendimi i dt.23.02.2010 dhe i datës së protokolimit 22.03.2010 nga Ministria e Tregëtisë dhe Industisë.

Nuk është kontestuese se i padituri i ka paditësit borxh, pasi një gjë të tillë gjykata e vërteton pikërisht në bazë të pasqyrës së llogarisë bankare të paditësit e dt. 24.02.2010, sipas të ciles i padituri ka qenë i obliguar që për çdo muaj, t'ia paguaj paditeses shumën prej 300 euro, ashtu që I padituri pesë muaj ka mbetur mbrapa me pagesë apo shumën totale prej 1500 euro.

I padituri me asnjë provë të vetme nuk e dëshmoi, se bashkëpunimi me paditësin është ndërprerë pas 6 muajve gjë që gjykata kur e vlerësoi në raport me provat tjera nuk ia falë besimin e plotë.

I padituri në fjalën e tij thekson se, kërkuar nga paditësi ta mbikqyr një project, dhe se paditësi po kërkon një padi shumën e caktuar edhe pse nuk ka qenë I angazhuar fare.

Mirëpo pretendimet e palës së paditur bien në kundërshtim me vetë kontratën e bashkëpunimit pasi në kontratë në mënyrë të qartë

theksohet se lidh marrëdhënie pune me personin (paditësin) për momentin vetëm shfrytëzimin e diplomës ndërsa është përmendur se për angazhimet të tjera edhe pagesa do të ndryshon.

Më pastaj nëse e shikojmë licencën të cilën e ka marrë firma e të paditurit, kjo licencë është marrë për një periudhë 3 vjeçare, duke u bazuar në diplomën e paditësit, në të kundërtën i padituri nuk do të kishte mundësi të licencimit të firmës së tij.

Marëdhëniet e paditësit me të paditurin deri me datën 22.03.2010, kur zyrtarisht Ministria e Tregtisë e ka njoftuar paditësin me shkresën e të paditurit për ndërprerjen e bashkëpunimit.

Ndërsa për gjykatën është jo kontestues fakti se deri me këtë datë të lartëcekur konsiderohet se i padituri ka pasur obligim ndaj paditësit, pasi deri me atë datë ka ekzistuar licenca pavarësisht faktit se firma a ka qenë duke punuar apo jo.

Gjykata me rastin e vendosjes, vendosi duke marrë për bazë dispozitat e nenit 17, 124 dhe 262 të LMD-së të aplikueshëm në rastin konkret, ku gjykata duke vepruar në bazë të çmuarjes së lirë të provave dhe duke pas parasysh edhe dispozitat e Kontratës për shfrytëzimin e diplomës për licencim dt. 11.03.2010, e aprovoi padinë për pagimin e borxhit.

Gjykata, lidhur me caktimin e kamatës vjetore, u bazua në nenin 277, par.1 të Ligjit mbi Marrëdhëniet e Detyrimeve të aplikueshëm në rastin konkret, ndërsa, lidhur me lartësinë e saj, u bazua në lartësinë e mjeteve të deponuara në bankat afariste për një vit pa destinim të caktuar

Sa i përket shpenzimeve procedurale gjykata u bazua në nenin 452 paragrafi I të LPK-së, ku pala e cila e ka humb kontestin duhet t'ia paguajë palës tjetër shpenzimet procedurale.

Andaj gjykata duke u bazuar në nenin 143 të LPK-së vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË**

**C.Nr.20/2012 datë: 18.11.2013**



**UDHËZIM MBI MJETIN JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, palët e pakënaqur ka të drejtën e ankesës në afat prej 15 ditorë nga dita e pranimit së të njëjtit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë – nëpërmjet kësaj Gjykate.